

VENDIM
Nr. 704, datë 10.10.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 602, DATË 24.8.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E MËNYRËS SË PËRDORIMIT TË FONDEVE
KUNDËRPARTI, TË MBLEDHURA NGA GRANDET JAPONEZE PËR SEKTORIN E
BUJQËSISË DHE TË USHQIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 602, datë 24.8.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, fjalët “... të derdhen në buxhetin e shtetit...”, zëvendësohen me fjalët “... të derdhen pjesë-pjesë në buxhetin e shtetit, në përputhje dhe në varësi të fondit të kontraktuar...”.
 2. Në pikën 1.1, fjalët “... shuma prej 200 000 000 (dyqind milionë) lekësh ...” zëvendësohen me fjalët “... shuma e kontraktuar ...”.
 3. Në pikën 2, fjalët “... këto fonde ...” zëvendësohen me fjalët “... fondet e kontraktuara ...”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha